

URDHËR
Nr. 1049, datë 2.12.2024

PËR LICENCIMIN E “SHOQATËS SË FILMIT AUDIOVIZUAL, ARTISTIK DHE DOKUMENTAR (F.A.A.D)” SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË AUTORËVE DHE PRODUCENTËVE TË VEPRAVE AUDIOVIZUALE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,

URDHËROJ:

1. Licencimin e subjektit F.A.A.D, shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 7388, datë 10.9.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me NIPT: M42116451I, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve dhe producentëve të veprave audiovizuale.
 2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
 3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
 4. Ngarkohet F.A.A.D për njoftimin e Sportelit Unik lidhur me anëtarësimin në Bordin e Drejtorëve.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja